



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1162 / Prot.

Patos, më 13 05 / 2026

PROCESVERBALI I TAKIMIT 12 MAJ 2026

Vendi: Njësia administrative Ruzhdie

Ora e fillimit: 09:00

Ora e mbarimit: 09:30

Dëgjese publike me temë: “Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin Paketa e Maleve”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës me nr. 1162 prot, datë 01.04.2026 të drejtorisë së Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile për zhvillimin e dëgjësës publike me temë: Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin në “Paketën e Maleve”.

Pjesëmarrës: Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj, Kryetar i Bashkisë Patos, z. Fation Duro, Zv/Kryetar znj. Ina Sauli, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Sekretare e Përgjithshme znj. Jucla Shpata, Drejtore znj. Boreta Murati etj me pjesëmarrjen e **16 pjesëmarrësve** (banorë, kryetarë të fshatrave, përfaqësues të bashkisë Patos etj)

Takimin hapet nga Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Të nderuar të



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Qëllimi i kësaj dëgjese është informimi mbi Paketën e Maleve. Ju ftoj të dëgjojmë prezantimin nga ana e ekzekutivit dhe më pas presim pyetjet tuaja lidhur mbi këtë temë.

Kryetar i Bashkisë, z. Fation Duro– Përshëndetje të gjithëve! Qëllimi i këtij takimi është të informojmë mbi Paketën e Maleve dhe ju të shprehni interesin mbi këtë proces. Zona prioritare në Patos do të jenë të shtrira në komplet njësinë administrative Ruzhdie, Kuqarin.



**Kryetar i Bashkisë
z. Fation Duro**
Dëgjese publike me temë:
Dëgjese publike me temë:
**“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**
Maj 2026

Në pjesën e dytë mund të shtohet dhe Rrërësi me Rusinjën. Ideja e Paketës së Maleve është që personat që janë posedues të tokës, por jo pronarë dhe që kanë marrë një tokë për ta zhvilluar në kuadër të turizmit mund të aplikoj në Paketën e Maleve dhe do të mund të kenë një mënyrë për ta zhvilluar me hapa shumë të shpejt. Kjo është një nismë e qeverisë që nga viti 2025. Kjo është një mënyrë që për ata persona që kanë një tokë që e posedojnë për më shumë se 10 vjet, të kenë mundësi për ta zhvilluar dhe përfituar tokën. 500 përfituesit e parë janë të përjashtuar nga taksat. Nqse do të ketë pretendime nga dikush kur të fillojnë procedurat për të qënë pjesë e Paketës së Maleve mbas miratimit të zonave prioritare, bëhet kërkesa, më pas shqyrtohet nga bashkia dhe Këshilli Bashkiak. Më pas hartohet Plani i investimeve nga personat që do përdorin këtë tokë, del leja përkatëse në Ministri dhe më pas dokumentacioni paraqitet për të bërë blerjen e tokës me vlerën prej 1 lekë. ASHK në momentin e miratimit të zonës prioritare në secilën bashki, fillon regjistrimin fillestar me procedura të përshpejtuar. Rishikohet dhe njëher harta dhe vazhdon procedura. Pra edhe njëherë kjo bëhet vetëm për toka që janë shtet dhe personi është posedues për një periudhë jo më pak se 10 vjet. Kjo vërtetohet nëpërmjet faturave tatimore, ortofotot e ndryshme që tregojnë zhvillimin e zonës, dhe mënyrave të tjera që tregojnë që kjo tokë ka qënë në përdorim të personit që aplikon. Duhet edhe vërtetim nga kryeplaku i zonës. Kjo pronë qëndron e afishuar rreth 45 ditë dhe nëse ka pretendime të tjera për atë tokë vendosen në dijeni.

Banor i Ruzhdies, z. Veis Myftaraj– Përsëritet! Unë jam shumë dakord me ato çfarë iu shpjeguan nga ana juaj. Unë kam gjithë ata ulla të mbjell, e kam tokën me qira, por unë nuk kam rrugë që të kaloj makina dhe ti mbledh ulla. Unë nuk kam vend ku ta magazinohet ulla dhe të marrim firmë. Duhet të ketë dhe një çmim nga shteti që ne të çojmë ulla.



**Banor i Ruzhdies
z. Veis Myftaraj**

**Dëgjese publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”
Maj 2026**

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Në qoftë se ke një tokë me qira nuk je përfitues i Paketës së Maleve. Duhet të jesh posedues jopronarë i tokës shtet që të përfitosh.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjese publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”
Maj 2026**

Banor i Ruzhdies, z. Adrian Myftaraj- Unë e kam ndjekur Paketën e Maleve dhe prej viteve kam investuar në një pronë këtu në zonën e Ruzhdies. Historia e pronës ku unë kam investuar për të bërë një agroturizëm ka filluar shumë më herët. Duke qënë se familja ime ishte larguar nga fshati para vitit 1991 ne nuk u bëm dot subjekt i ligjit 7501 dhe nuk përfituam tokë. Unë e posedova për disa vite dhe kam investuar mbi 1000 rrënjë ulla. Rreth viteve 2010,2011 kur doli ligji për tokat e ish komunave që jepeshin me qira, aplikova dhe e mora atë tokë me qira. Në vitin 2017 KLSH e nxori shkelje këtë kontratë sepse kishte shkelje ligjore. Mbas kësaj bëra aplikim të ri brenda kuadrit ligjor. Brenda gjithë kësaj sipërfaqe toke unë kam dhe pronën time që kam ngritur që është me certifikatë pronësie. Ajo që dua të them është se pavarësisht qirasë së paguar rregullisht, dua të bëj një pyetje të thjeshtë. Unë sot i kam pronat pranë ASHK në sesionin e veçantë të pronave me qira. I kam të regjistruara si përdorues me qira me kontratë me bashkinë Patos. Unë nuk do të përfitoj sepse njihem me

kontratë qiraje? Ka persona të tjerë që nuk i kanë regjistruar pronat si unë. Objekti im punon me dhënie të dhomave me qira për turistët. A mund të futet objekti im në Paketën e Maleve, duke qënë se unë dua të zhvilloj agroturizëm dhe pres turistë në këtë zonë? Po këta të tjerët që nuk kanë kontratë qiraje, a aplikojnë? Pra unë që jam i rregullt me dokumentacion nuk aplikoj dot në Paketën e Maleve, ndërsa këta të tjerët që nuk kanë kontratë qiraje aplikojnë sepse njihen si posedues jopronarë?



**Banor i Ruzhdies
z. Adrian Myftaraj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

Kryetar i Bashkisë Patos, z. Fation Duro- Në rastet që kemi të bëjmë me një që pretendon që është pronarë, por në bazë të ligjeve që janë në fuqi ai nuk ka mundur ta bëjë dot me certifikatë pronësie, këta persona kanë të drejtë të aplikojnë në Paketën e Maleve. Në rastin tuaj që e mbron me një dokumentacion dhe e keni marrë me një kontratë qiraje, ligji nuk e parashikon që ju të aplikoni në Paketën e Maleve.



**Kryetar i Bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

Banor i Ruzhdies, z. Ardjan Myftaraj- Unë kërkoj nga ana juaj si përfaqësues të institucioneve një dokument ligjor që më përjashton nga Paketa e Maleve. Unë jam drejtuar me shkresa pafundësisht, me emaile etj. Doja të bëja një pyetje tjetër. Kur kam marr token me qira ka qënë thjesht tokë bujqësore. Kontata u bë si e tillë për arsye se nuk ishte as Plani i Përgjithshëm Vendor. Më pas administrata e bashkisë bëri planin dhe plani më thotë që unë

mund ta zhvilloj zonën edhe për agroturizëm. Dua të di, kur Plani i përgjithshëm vendor parashikon zhvillimin e agroturizmit pse pikërisht ku kam unë objektin nuk zhvilloj dot agroturizëm? Që unë të aplikoj për leje mua më duhet miratim nga ana e bashkisë si kontraktorë që më jep te drejtë të zhvilloj agroturizëm në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor. Sepse kontrata e parë është bërë kur nuk ka pasur Plan të Përgjithshëm Vendor dhe



**Banor i Ruzhdies
z. Ardjan Myftaraj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

nuk ma jepte bashkia të drejtën për agroturizëm sepse dilte shkelje ligjore. Më vonë u bë Plani i Përgjithshëm Vendor dhe ma lejon. Edhe në pasurinë me nr. 5/4 më lejohej agroturizmi sipas Planit. Pra ju si bashki duhet të më jepni të drejtën me aneks kontrate që unë të zhvilloj agroturizëm. Nëse unë nuk e zhvilloj dot me Paketën e Maleve, ta zhvilloj të paktën me aneks kontrate në mënyrë ligjore. Unë kam investuar prej vitesh në atë tokë dhe zona jonë ka nevojë për zhvillimin e agroturizmit.

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- E përshkruan ligji Nr. 20/2025 “Për Paketën e Maleve” arsyen se pse ju si marrës i tokës me qira nuk aplikoni dot në Paketën e Maleve. Ligji thotë personat që përdorin toka shtet pa tituj pronësie dhe janë posedues jopronarë aplikojnë në Paketën e Maleve. Në momentin që do të hapen zonat prioritare dhe do të miratohen ti mund të aplikosh në sistem për Paketën e Maleve nëse dëshiron. Ju jeni përdorues që keni marrë tokën me qira dhe figuroni edhe në ASHK që keni marrë këtë tokë me qira. Në certifikatën e pronësisë duhet të shënohet që jeni okupues, posedues jopronarë i tokës dhe kjo duhet të vërtetohet që ky person që ka marrë tokën minimalisht për 10 vjet, ta vërtetoj lidhjen me këtë tokë duke përdorur faturat tatimore që ka blerë mbjelljet për këtë tokë. Gjithashtu ortofoto të viteve të ndryshme. Nëse do të aplikosh për leje zhvillimi, ka një sistem online e Albania që aplikohet për leje zhvillimi nëse do të ndërtohet diçka në pronën tënde. Aplikon nëpërmjet sistemit dhe ju do ju vij përgjigja online.

Drejtores, znj. Boreta Murati- Plani i Përgjithshëm Vendor është online dhe transparentë për të gjithë. Për pjesën e pronës të cilën ju e keni me certifikatë pronësie, mund ta zhvilloni duke



**Drejtores
znj. Boreta Murati**

Dëgjesë publike me temë:

**“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

bërë aplikim nëpërmjet e Albania. Për sa ka parashikuar Plani Përgjithshëm Vendor për pasurinë që ju keni me dokument, pasi ju keni aplikuar dhe në sistem ju mund ta shikoni dhe aplikoni përsëri për zhvillimin e turizmit sepse Plani i parashikon shërbimet dhe ju vjen përgjigja online.

Banor i Ruzhdies, z. Adrian Myftaraj – Unë kam dhe një pjesë toke që nuk e kam me



**Banor i Ruzhdies
z. Adrian Myftaraj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

kontratë qiraje dhe jam posedues jo pronarë, a aplikoj për këtë tokë në Paketën e Maleve? Dua ta di çfarë ndodh nëse unë aplikoj, por ngrihen pretendues të tjerë lidhur me këtë tokë? Gjithashtu për pronën që dua ta zhvilloj agroturizëm, kërkoj ndërhyrje nga ana juaj për të dërguar shkresë në institucione më lart lidhur me problemin tim sepse unë nuk kam aktualisht aneks kontrate për agroturizëm. Unë dua të kem dhe kontratën të rregullt ku të përfshihet zhvillimi i agroturizmit dhe Planin në rregull që të veprojmë. Unë kam vite që e ndjek këtë procedurë për legalizimin e pronës dhe kërkoj të shikoni mundësitë ligjore se si mund ta zgjidh këtë çështje. Sepse që unë të futem në agroturizëm mua më duhet deri në 6 vjet që të kem eksperiencë në bujtina dhe unë aktualisht nuk e plotësoj këtë kusht. Problemi im lidhet sepse duhet të zhvilloj një aneks kontrate në agroturizëm dhe të më japi pushteti vendor pëlqimin e tyre për ta zhvilluar këtë gjë. Këshilli bashkiak gjithashtu mund të drejtohet

organeve më lart dhe të thotë në zonë 5/4 ku Plani e parashikon agroturizmin, ne kërkojmë zgjidhjen e këtij aneksi kontrate pasi qytetari është drejtuar me kërkesë për aneks kontrate të tillë.

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Po për këtë tokë ti mund të aplikosh në Paketën e Maleve. Nëse ngrihen pretendues të tjerë gjatë procesit atëhere pezullohet procesi dhe veprohet në bazë të ligjit. Ndaj duhet dhe ta vërtetoni që ju e posedoni për shumë vite këtë tokë me disa mënyra siç janë faturat, foto ndër vite, dëshmi të kufitarëve etj. Lidhur me problemin e agroturizmit që ju përmendët do ta shqyrtojmë nga ana juridike dhe të shikojmë mundësitë në rrugë zyrtare për tu drejtuar institucioneve më lart për pjesën e aneksit të kontratës.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike me temë:

**“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xcha